



RREGULLA TË PËRGJITHËSHME PËR PËRDORIM

Kapital Bank SHA Shkup publikon në faqen e saj dokumente, informacione dhe të dhëna që kanë për qëllim të informojnë klientët e saj - personat fizik dhe juridik.

Produktet dhe shërbimet e përshkruara të përmbajtura në veb faqen e saj janë pronë e saj. Kapital Bank SHA Shkup e mban të drejtën ta kufizoj ose ta ndaloj qasjen tek veb faqja prkohësisht ose përgjithmon. Banka e mban të drejtën ta ndryshojë përmbajtjen dhe strukturën e veb faqes në çdo kohë dhe atë pa njoftim paraprak dhe përgjegjësi për të.

Kushte për përdorim

- Përmbajtjet ose më saktë informacionet në veb faqe janë me karakter informativ dhe të njëjtat mund të merren, të përktëhen, të kopjohen, të shtypen por vetëm për përdorim personal. Informacionet e prezantuara duhet të interpretohen vetëm në bazë të teksteve origjinale dhe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale dhe as të distribuohen personave të tretë.
- Me qëllim sigurim të të dhënave të duhura për produktin apo shërbimin të cilët janë në pronësi të bankës, klientët e interesuar mund ta kontaktojnë bankën për të dhënat e vëna në veb faqe.
- -Krijimi i lidhjeve, ndryshimi i pamjes apo përmbajtjes së veb faqes së bankës pa pajtim paraprak të saj, i jep të drejtën bankës, të kërkojë nga organet kompetentë të marrin masa.

Heqja e përgjegjësisë

Banka kapital SHA SHkup, në veb faqen e saj publikon të dhëna të sakta të cilat rregullisht kontrollohen dhe ripërtërihen. Megjithatë Banka nuk mban asnjë përgjegjësi për saktësinë, kompletësinë dhe ripërtëritjen e informacioneve. Në qoftë se përdoruesit e veb faqes, personat fizik dhe juridik e sjellin vendimin e tyre vetëm në bazë të të informacioneve nga veb faqja e bankës, vet i mbajnë pasojat nga vendimi i marrë, më saktë qasja e tyre tek veb faqja dhe përdorimi i të dhënave janë tërësisht risk i tyre. Veb faqja e bankës prmban lidhje të cilat janë në dobi të klientëve, por të njëjtat nuk janë në kompetencë të bankës. Banka nuk mban përgjegjësi në lidhje me përmbajtjen ose ndryshimin e së njëjtës.

Të drejtat autoriale

Kapital Bank i mban të drejtat që dalin nga nga kjo veb faqe, më saktë e njëjta ka të drejta autoriale komplete mbi përmbajtjen e veb faqes. Logoja e Bankës Kapital është e mbrojtur në drejtim të të drejtave autoriale dhe vetëm Banka ka të drejtë ta përdor të njëjtën në etiketimin për ti definuar produktet e saj, më saktë shërbimet. Banka nuk lejon përdorim e logos gjatë korespondencës, njoftimeve dhe reklamimeve si dhe ndryshimeve, reproduktimit pa pajtim me shkrim të bankës.

